



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 281/3 Prot.

Tiranë, më 17.03. 2026

Lënda: Kërkesë e përsëritur për parashtrime.

Z. ROBERT STERKAJ

Pjesmarrës në Programin Big Brother Albania Vip, Televizioni Kombëtar Top Channel
Rruga "17 Nëntori", Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar
Tiranë

Sikurse jeni vënë në dijeni me shkresën tonë nr. 281/1 prot., datë 18.02.2026, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*kopjen e së cilës e gjeni bashkëlidhur*), është duke u shqyrtuar ankesa nr. 38, datë 05.02.2026, e paraqitur nga Fondacioni Së Bashku kundër Top Channel, Big Brother Albania Vip, z. Rogert Sterkaj, pjesmarrës në programin Big Brother Albania Vip, në Televizionin Kombëtar Top Channel, me pretendimin për diskriminim për shkak të "aftësisë së kufizuar".

Në kuadër të procedurave për shqyrtimin e ankesës dhe në zbatim të parashikimeve ligjore të neneve 32, pika 2 dhe 33, pika 7, të Ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, me shkresën e sipërcituar, Komisioneri ka kërkuar prej jush informacion dhe dokumentacion, në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ana e palës ankuese.

Në kushtet kur nuk kemi marrë asnjë përgjigje, Ju rikërkojmë që të deponitoni pranë Komisionerit:

- Parashtrime me shkrim mbi pretendimet e palës ankuese, si dhe çdo shpjegim apo informacion që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Sa më sipër kërkohet, duhet të depozitohet sa më shpejtë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja dijani për këtë kërkesë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin..

KOMISIONERI

Robert GAJDA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**DREJTORE E
DREJTORISË SË HETIMIT
ADMINISTRATIV**

VILFRIDA BUSHATI

